



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 1310/3 /prot.

Tiranë më 3.10 2018

**REKOMANDIM**

Nr. 24, datë 3.10.2018

**PËR KONTROLLUESIN TELEKOM ALBANIA SH.A**

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1, dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, në ngarkim të kontrolluesit "**Telekom Albania Sh.A (ish-Albanian Mobile Communications AMC)**",

**KONSTATOVA SE:**

Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është paraqitur ankesa e shtetases znj. . Kjo shtetase i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë ku pretendon se, kompania Telekom Albania sh.a (ish-Albanian Mobile Communications AMC) në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave ka përhapur të dhënat e saj duke ekspozuar të gjithë korrespondencën e email-ve të dërguara midis kontrolluesit dhe ankueses kundrejt një personi të tretë, të panjohur, me adresë emaili

Në kuadër të zgjidhjes së ankesës, Zyra e Komisionerit ka kërkuar pranë jush informacion me shkresën nr. 1310/1 prot, datë 10.09.2018, nëpërmjet së cilës u kërkua informacion lidhur me pretendimet e ankueses. Në përgjigjen e kontrolluesit administruar me nr. 1310/2 prot, datë 20.09.2018, Telekom Albania sh.a ka paraqitur sqarime, ku ka shpjeguar se:

*Pajtimtarja znj. është ankuar për tarifimin e thirrjeve ndërkombëtare të muajit maj 2018 në adresën e postës elektronike [customercare@telekom.com.al](mailto:customercare@telekom.com.al) (kujdesi ndaj klientit).*

*Pajtimtarit i është kthyer përgjigje nga ana e Telekom Albania sh.a në datën 26.06.2018 duke shpjeguar dhe saktësuar që tarifimi i kryer është i saktë, pasi ka përfunduar njësitë free (falas) të programit të saj.*

*Gjatë kësaj date 26.06.2018, pajtimtari ka dërguar sërish një komunikim elektronik (postë elektronike) të dytë ku pretendon se nuk ishte e qartë në mënyrën e tarifimit të numrit të*

saj dhe thekson që tarifat nuk i janë bërë transparente me këto komente : “E fundit, më lejoni t’ju bëj me dije se në lidhje me vlerën e përmendur për zonën në Gjermani nuk ka pasur asnjë lloj transparence nga ana juaj, ku të informohemi për këtë fakt. Me shpresën që do ta rishikoni me seriozitet mbetem në pritje të përgjigjeve të pikëpyetjeve në lidhje me këtë çështje”.

Në datën 27.06.2018 Telekom Albania sh.a i ka kthyer sërish përgjigje Pajtimtarit, në lidhje me tarifimin e numrit të saj, duke i shpjeguar të gjitha tarifat përkatëse dhe gabimisht (lapsus njerëzor) është vendosur për dijëni edhe një adresë postë elektronike i një pajtimtari tjetër të Telekom Albania sh.a (A.K) me këtë adresë kur në fakt nga ana e punonjësës tonë (E.L) është dëshiruar dhe synuar të vihet në dijëni (c.c) për korrespondencën e mbajtur vetëm pika e kontaktit (A.K) me adresë poste elektronike , e cila është punonjëse e Telekom Albania sh.a që mbulon problematikën e një portofoli të caktuar Pajtimtarësh.

Saktësojmë se adresa është ruajtur në mënyrë automatike nga përgjigja që kemi kthyer disa kohë më parë kësaj pajtimtare në lidhje me ankesën e saj. Ngjarja ka ndodhur si pasojë e një lapsusi njerëzor që nuk ka pasur për qëllim përhapjen e të dhënave personale apo sensitive, me dashje ose në kushtet e neglizhencës .

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit në kuadrin e dhënies së informacionit në lidhje me rrethanat e rastit konkret.

Megjithatë, në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Zyra e Komisionerit vlerëson se përhapja e të dhënave personale drejt subjekteve të tjera kontrolluese konsiderohet përpunim dhe përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të këtij ligji.

Kontrolluesi Telekom Albania sh.a ka sqaruar se përhapja e të dhënave personale të ankueses ka ndodhur si rezultat i një gabimi njerëzor. Në lidhje me këtë pretendim Zyra e Komisionerit vlerëson se është përgjegjësi e kontrolluesit për të marrë masat e nevojshme teknike dhe organizative të përshtatshme për të mbrojtur aksesin ose përhapjen e të dhënave nga persona të paaautorizuar, për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, sipas parashikimit në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 27, 29, 30 dhe 31 pika 1 gërma a/1 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi Telekom Albania sh.a (ish-Albanian Mobile Communications AMC), në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të ketë në vëmendje përmirësimin e masave të sigurisë në drejtim të garantimit të procesit përpunimit të të dhënave për të mbrojtur aksesin ose përhapjen e të dhënave te persona të paaautorizuar, për të mbrojtur të dhënat personale.

2. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 3 / 10 / 2018

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

